



TV Opinion
Edvard KOLNDREKAJ
Drejtor
Prizren

Ankesa Nr. 2017/215 KPM vs TV Opinion
Ref:1711/1276/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2017/215 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër TV Opinion (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është televizion regjional me seli në Prizren. Pala Përgjegjëse është pajisur me licencë të KPM-së me datën 30 tetor 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-44 tw KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, me anë të të cilit përcaktohet sjellja e mediave gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë Udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje.
3. Pala Përgjegjëse me Vendim të Komisionit të KPM të datës 10 gusht 2017 është dënuar me Vërejtje për shkeljet e bëra gjatë fushatës zgjedhore në Zgjedhjet e Përgjithshme 2017 në Republikën e Kosovës, duke transmetuar spote politike të cilat nuk i ka identifikuar se nga kush janë të sponsoruara.
4. KPM me datën 21 shtator 2017 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, me qëllim që t'i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore në Zgjedhjet Lokale 2017 në Republikën e Kosovës.
5. KPM bazuar në raportin e monitorimit të datës 24 tetor 2017, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për pajtueshmërinë e Palës Përgjegjëse me Ligjin Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, ka gjetur se Pala Përgjegjëse gjatë prezantimit të fushatës së partive politike në edicionet e lajmeve ka dominuar prezantimi i fushatës së PDK-së, por pas kontaktimit nga KPM, ka ardhur në pajtueshmëri. Mirëpo, Pala Përgjegjëse ka bërë

shkelje të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme duke i dhënë hapësirë në reklama dhe emisione vetëm subjekteve politike për transmetim me pagesë, e duke mos ofruar asnjë hapësirë pa pagesë për subjektet tjera politike.

6. KPM në bazë të të gjeturave nga raporti i monitorimit, me datën 25 tetor 2017, i ka dërguar Njoftim për Shkelje Palës Përgjegjëse, me të cilin është njoftuar për shkeljet e bëra dhe i është kërkuar të përgjigjet menjëherë pas pranimit të tij.

Analiza Ligjore

7. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2017 në Republikën e Kosovës i ka mundësuar hapësirë në reklama dhe emisione vetëm subjekteve politike për transmetim me pagesë, e duke mos ofruar asnjë hapësirë pa pagesë për subjektet tjera politike, duke vepruar në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton se:

“Nga transmetuesit të cilët vendosin të emetojnë reklamim politik me pagesë kërkohet që gjatë periudhës së fushatës t’i ofrojnë një sasi minimale minutash të kohës për emetim pa pagesë secilit subjekt politik të certifikuar.”

Zyra Ekzekutive e KPM-së konstaton se Pala Përgjegjëse këtë obligim ka mundur ta përmbushë duke u bazuar në nenin 49, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton se:

“Kjo kohë e emetimit pa pagesë mund të sigurohet sipas vlerësimit të transmetuesve individual, në formë të pjesëmarrjes në debate, programe diskutimi, intervista jashtë programeve të rregullta informative të parapara, ose si pika reklamuese politike pa pagesë.”

Vendimi

8. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 49, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.
9. Komisioni bazuar në nenin 30, paragrafi 1.3, të Ligjit të KPM-së sanksionon me gjobë në vlerën prej 1.000 (njëmijë) euro Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 49, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

E drejta për Ankesë

10. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 04/L-44 të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

11. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar



08.11.2017
Datë